

## Pyetje dhe përgjigje për thirrjen e tretë të integritit social të të rinjve

### “Skema e Luksemburgut për shoqërinë civile në Kosovë”

- 1. A ekziston mundësia e aplikimit si media e cila është në gjuhën turke dhe mundëson integrimin e pakicave dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese për ta?**
  - Po, vetëm keni parasysh se përvoja relevante në këtë fushë i shton 20% vlerësimin të përgjithshëm të projektit. Shtesë, duhet të jeni të regjistruar dhe ta keni çertifikatën e OJQ-së lëshuar nga Departamenti për OJQ.
- 2. A lejohet që si individ pa OJQ me bë ndonjë propozim projekt?**
  - Jo, vetëm OJQ-të mund të aplikojnë në këtë thirrje.
- 3. A kemi mundësi me apliku ne nga Gjilani me ndonjë projekt?**
  - Po, thirrja është e hapur për OJQ-të nga e tërë Kosova.
- 4. A lejohen konzorciumet në aplikim (Përfituesi dhe Aplikuesi)?**
  - Po, vetëm se përfitues në këtë rast janë personat e targetuar me projekt pra ata nuk mund të jenë partner në zbatim të projektit. Sa i përket konzorciumeve, partneritetet inkurajohen dhe aplikantët mund të jenë udhëheqës ose partner në aplikim.
- 5. Pasi që ne si organizatë e tejkalojmë kriterin "Të këtë qarkullim vjetor jo më shumë se 25,000 EUR në vit", pyetja jonë lidhur me këtë çështje është se a do të kishim mundur që megjithatë të aplikojmë në thirrjen tuaj?**
  - Jo, ky është kusht dhe kriter i panegociueshëm. Aplikanti duhet të ketë qarkullim vjetor më të ulët se €25,000 në vit për tri vitet e fundit.
- 6. A mund të aplikojnë organizatat e reja që janë krijuar gjatë vitit 2019?**
  - Po, mund të aplikojnë OJQ-të e reja dhe të regjistruara së fundmi. Por, keni parasysh specifikimin në thirrjen për propozime (Udhëzuesi për Aplikim) ku theksohet se Kapacitetet e organizatës dhe përvoja relevante i shton 20% vlerësimin të përgjithshëm të projektit.
- 7. Ne jemi një institut në formim e sipër të Qendrës për Aftësim Profesional dhe akreditimit të saj në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve. Andaj, pyetja jonë është se a mund të kualifikohet projekti jonë për qëllime të Integritit social të të rinjve tek Objektiva 2 e thirrjes?**
  - Po, aplikimi mund të bëhet në njërin nga dy objektivat dhe mund të aplikojnë OJQ-të e reja (themeluara kohëve të fundit). Por, keni parasysh specifikimin në thirrjen për propozime (Udhëzuesi për Aplikim) ku theksohet se Kapacitetet e organizatës dhe përvoja relevante i shton 20% vlerësimin të përgjithshëm të projektit.
- 8. A kemi drejtë të aplikojmë për këtë thirrje, duke pasur parasysh se organizata jonë qarkullimin për 3 vite e ka zero (0)?**
  - Po, mund të aplikojnë OJQ-të e reja (themeluara kohëve të fundit). Por, keni parasysh specifikimin në thirrjen për propozime (Udhëzuesi për Aplikim) ku theksohet se Kapacitetet e organizatës dhe përvoja relevante i shton 20% vlerësimin të përgjithshëm të projektit.

9. **A kemi të drejtë aplikimi dhe si do të ndikonte në vlerësim të projekt-propozimit aplikimi i një organizate të re? Realisht, edhe pse jemi një organizatë shumë e re, jemi shumë aktivë dhe momentalisht jemi duke punuar në realizim të 4 projekteve vullnetare me një rol dhe rëndësi të lartë?**
- Po, mund të aplikoni por keni parasysh specifikimin në thirrjen për propozime (Udhëzuesi për Aplikim) ku theksohet se Kapacitetet e organizatës dhe përvoja relevante i shton 20% vlerësimin të përgjithshëm të projektit.
10. **Të ketë qarkullim vjetor jo më shumë se 25,000 EUR në vit (në secilin nga tre vitet e fundit: 2017- 2018-2019) si dhe të jetë organizatë me bazë në komunitet. A është strikt, apo varet edhe prej kritereve tjera të plotësuara?**
- Po është strikt, andaj për të pasur mundësi aplikimi, aplikanti duhet të ketë qarkullim vjetor më të ulët se €25,000 për secilin vit 2019, 2018 dhe 2017.
11. **Ne si organizatë nuk kemi pasur qarkullim më shumë se 5,000 EUR – 6,000 EUR dhe 2 vitet e fundit kemi pauzuar për shkak të disa punëve tjera personale. Pyetja jonë është se a mund të aplikojmë dhe të kemi partner një organizatë me qarkullim më të lartë se 25,000 EUR për tri vitet e fundit?**
- Po, mund të aplikoni ndërsa sa i përket partneritetit me organizata që kanë tejkaluar qarkullimin vjetor prej €25,000, kjo nuk lejohet pasi kriteri i njëjtë vlenë për të gjithë, si për aplikantët ashtu edhe për partnerët.
12. **Cila është mosha për të aplikuar në këtë thirrje dhe a duhet të jemi OJQ apo mund të aplikojmë edhe me biznes plan?**
- Kjo thirrje për aplikime është vetëm për OJQ, dhe jo për biznese. Nuk ka kriter të moshës pra mund të aplikojnë të gjithë përfaqësuesit e organizatave të regjistruara në Kosovë. Aplikimi bëhet vetëm me format e caktuara nga KCSF andaj nuk mund të aplikohet me biznes plan apo formë tjetër. Forma për aplikim dhe shtojcat mund të shkarkohen në këtë link: <https://www.kcsfoundation.org/activity/thirrje-per-projekt-propozime-integrimi-social-i-te-rinjve/>.
13. **A mund të aplikojnë kompanitë kontabiliteti në këtë thirrje pasiqë qëllimi jonë është avansimi i të rinjve në fushën e kontabilitetit si dhe punësimi i tyre?**
- Jo, vetëm Organizatat Jo Qeveritare (OJQ) mund të aplikojnë në këtë thirrje.
14. **A mund të aplikojnë organizatat ndërkombëtare (italiane) që janë të regjistruara në Kosovë në këtë thirrje?**
- Po, mund të aplikojnë organizatat që posedojnë certifikatë regjistrimi dhe numër fiskal të Kosovës.
15. **A ka limit të caktuar për buxhetin e personelit të projektit?**
- Jo nuk ka limit.
16. **A ka limit të caktuar për shumat e nën-grantimit të paleve të treta?**
- Jo nuk ka limit. Por keni parasysh se përkrahja e vogël financiare për përfituesit lejohet vetëm nëse të gjitha shpenzimet ekzekutohen nga organizata zbatuese.

- 17. A kemi të drejtë të përfshijmë në projekt krijimin e strategjisë për organizatën për 3 vite të ardhshme, pasi që jemi organizatë e re dhe kemi nevojë për një draftim të strategjisë për vitet e ardhshme?**
- Shpenzimet e projektit duhet të jenë të dedikuara për aktivitete që integrojnë të rinjtë andaj shpenzimet e fuqizimit të organizatës nuk përkrahen përmes kësaj thirrje.